

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® Antifreeze GR

ADITIV PËR BETONIM NË TEMPERATURA TË ULËTA



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Antifreeze GR është një aditiv i lëngshëm për prodhim betoni të cilësisë së lartë në temperatura të ulëta.

### PËRDORIMET

Sika® Antifreeze GR përdoret për:

- Betonim në temperatura të ulëta gjatë përzierjes, hedhjes dhe maturimit
- Raste ku pritet ngricë ose temperatura shumë të ulëta ambienti gjatë betonimit

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aktivizim i mpiksjes së çimentos
- Rritje e nxehtësisë së hidratimit
- Nuk përmban klorure dhe nuk ndikon negativisht tek armatura

### MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe Deklaratë Performance si aditiv për përsheptimin e mpiksjes (Tabela 6) sipas EN 934-2:2009+A1:2012, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe llojin e testimit.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Përzierje kripërash alkalesh dhe produkti të përbërë
Ambalazhi	Rifixho, fuçi 250 kg, bidon 20 kg
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, kafe
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~ 1.24 kg/l (në 20°C)
Vlera e pH	9.0 – 11.4 (në 20°C)

### TË DHËNA TEKNIKE

**Udhëzime për betonimin** Duhet të ndiqen rregullat standarde të praktikës së saktë të betonimit, në lidhje me prodhimin dhe vendosjen e betonit. Referohuni tek standardet përkatëse. Betoni i freskët duhet të maturohet në mënyrën e duhur.

### INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

**Doza e rekomanduar** 1.0 -1.5 % për peshë çimentoje

## Kompatibiliteti

Sika® Antifreeze GR mund të kombinohet me produktet e mëposhtme Sika®:

- Superplastifikatorët SikaPlast® / Sika® ViscoCrete® / Sika® ViscoFlow® (pa veti vonuese)
- SikaRapid®-2
- Sika® Ferrogard®-901 S
- Sika® Visco I-100
- Sika®-1+ / Sika® WT-200 P
- Sikafume® HR-E / Sikacrete® AR
- Sika-Aer® Fine

Rekomandohet të kryhen gjithmonë testime për të konfirmuar aplikimin e dëshiruar dhe karakteristikat e performancës.

## Mënyra e aplikimit

Sika® Antifreeze GR shtohet në ujin e përzierjes në fabrikë ose në betoniere.

## Kufizime

- Përdorimi i Sika® Antifreeze GR duhet bërë bazuar mbi një recetë të përshtatshme dhe duke testuar burimin e materialeve vendase.
- Sika® Antifreeze GR nuk duhet të shtohet në çimento të thatë.
- Sika® Antifreeze GR duhet të shtohet tek uji i përzierjes ose në fund të procesit të përzierjes.
- Gjatë betonimit në temperatura të ulëta, çimentoja, agregatet dhe uji duhet të kenë temperaturë të paktën mbi 0°C.
- Rekomandohet betonimi gjatë orëve të para të mëngjesit dhe jo pasdite.
- Betoni mund të ekspozohet në ngricë nëse arrin rezistencën minimale ndaj ngjeshjes prej 5 Mpa (DIN 1045).
- Rekomandohet përdorimi i çimentos me cilësi të lartë në miksi, me datë të afërt prodhimi dhe me mpiksje të shpejtë (lloji Rapid).
- Mbjajeni sa më të ulët të jetë e mundur raportin ujë / çimento. Në rast kërkese për punueshmëri më të mirë përdorni superplastifikatorët SikaPlast®, Sika® ViscoCrete®, Sika® ViscoFlow® pa efekt vonues. Mos përdorni ujë për shtimin e rrjedhmërisë.
- Gjatë mpiksjes dhe ngurtësimit betoni duhet të mbrohet me fleta plastike ose mjete të tjera që reduktojnë humbjen e nxehtësisë së hidratimit.
- Përpara aplikimit duhet të kryhen testime përshtatshmërie dhe duhet të zbatohen rregulloret lokale.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika® Antifreeze GR  
Mars 2019, Botimi 01.01  
021402011000000077

SikaAntifreezeGR-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf